UDHËZIM
Nr.2, datë 19.7.2004

MBI PËRCAKTIMIN DHE PLOTËSIMIN E MODELIT TË REGJISTRIT TË SHËRBIMIT TË VARRIMIT

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9220, datë 15.4 2004 "Për shërbimin publik të varrimit ", Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit

UDHËZON:

1. Regjistri i shërbimit të varrimit është dokumenti përmbledhës i të dhënave të shërbimit të varrimit.

2. Modeli i regjistrit të shërbimit të varrimit është unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë, sipas modelit tip që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Në këtë regjistër shënohen të dhënat e sakta për varrimet që kryhen, mënyrën e varrimit, ndryshimin që ka ndodhur si pasojë e zhvarrosjeve, si dhe të dhëna në plotësim të kërkesave të pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004 "Për shërbimin publik të varrimit".

4. Drejtoria, sektori apo zyra që mbulon veprimtarinë e shërbimit të varrimit të çdo bashkie ose komune bën administrimin e këtij regjistri.

5. Përgjegjësi i drejtorisë, i sektorit apo i zyrës përkatëse të bashkisë apo komunës i jep me procesverbal dy kopje të njëjta të regjistrit të shërbimit të varrimit, me numër të njëjtë fletësh dhe të nënshkruara nga kryetari ose sekretari i bashkisë apo komunës, ndërmarrjes ose shoqërisë private të licencuar që administron varrezat.

6. Ndërmarrja apo shoqëria private e licencuar që administron varrezat, plotëson regjistrin e shërbimit të varrimit, sipas kërkesave të nenit 7 të ligjit nr.9220, datë 15.4.2004 "Për shërbimin publik të varrimit".

7. Plotësimi i regjistrit bëhet nga një person i ngarkuar me këtë detyrë, bazuar në lejen e varrimit ose deklarimit të personave madhorë të familjes së të ndjerit sipas nenit 50 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile".

8. Plotësimi i regjistrit do të bëhet me shkrim të qartë dhe pa korrigjime, duke regjistruar të dhënat si më poshtë vijon:

a) të dhënat e sakta të identifikimit që merren nga gjendja civile nëpërmjet lejes së varrimit;

b) të dhënat e varrosjes si data, ora dhe numri i faturës;

c) lloji i varrimit kur kemi varrim nëntokësor, mbitokësor ose zhvarrim;

d) vendi i vendosjes me të dhënat që identifikojnë pozicionin e varrit në varrezat publike;

e) ndryshimet që mund të bëhen si rezultat i zhvarrimeve ose për vdekjet nga sëmundjet infektive, varrim i cili kryhet në kushte të veçanta.

Në rastet kur gjatë plotësimit të regjistrit bëhen gabime, korrigjimi i tyre bëhet sipas mënyrës së korrigjimit të regjistrave të gjendjes civile, konform nenit 27 të ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile".

9. Kontrolli ditor i regjistrimeve, në këtë regjistër, bëhet nga përgjegjësi i shërbimit të varrimit duke firmosur në çdo fletë mbas mbushjes të saj.

10. Ndërmarrja ose shoqëria private e licencuar e administrimit të varrezave duhet të bëjë rregullisht rakordimin e regjistrit të plotësuar nga ajo, me regjistrin themeltar të zyrës së gjendjes civile që ka lëshuar lejen e varrimit. Në rast të mospërputhjes të regjistrave, veprohet konform nenit 51 të ligjit nr.8950,datë 10.10 2002 "Për gjendjen civile".

11. Një kopje regjistri e plotësuar dorëzohet çdo fund viti në bashki ose komunë, ndërsa kopja tjetër mbetet pranë ndërmarrjes ose shoqërisë private të administrimit të varrezave. Kontrolli i të dhënave të regjistruara dhe i mënyrës së plotësimit të tyre, bëhet nga organet përkatëse të pushtetit vendor.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Bashkim Fino

RREGJISTER I SHERBIMIT TE VARRIMIT

Nr.	Emri Atesia Mbiemri	Mosha	Vendi i lindjes	Data e lindjes	Varrosja					Lloji i varrimit	Vendi i Vendosjes			Ndryshimet
					Dita	Muaji	Viti	Ora	Nr.i fat.		Parcela	Rradha	Nr.	

LLOJI I VARRIMIT : NENTOKESOR, MBITOKESOR, ZHVARRIMI